



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipality Kacanik

01 Nr. 104-1697/17
Kaçanik, 27.01.2017

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në bazë të nenit 57.1 dhe 57.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, në çështjen e shqyrtimit të Raportit Vjetor të Komitetit për Komunitete, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 27 Janar 2017, mori këtë:

VENDIM
PËR APROVIMIN E RAPORTIT TË PUNËS SË KOMITETIT PËR
KOMUNITETE PËR VITIN 2016

1. Me këtë Vendim, Aprovohet Raporti 01Nr. 104-1697/17, më tekstin e mëtejme: “Raporti i Komitetit për Komunitete, për vitin 2016” i hartuar nga Komiteti për Komunitete.
2. Raporti Vjetor si në pikën 1. të këtij Vendimi, përmban pikësynimet në lidhje me realizimin e detyrave nga fushë veprimtaritë që janë në kompetencë të Komitetit për Komunitete dhe nivelin e realizimit të tyre, për aktivitetin e zhvilluar për gjatë vitit 2016.
3. Raporti i Komitetit për Komunitete është i përmbledhur në gjithsej 6 faqe dhe i njëjti është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Me këtë Vendim njoftohet: Komiteti për Komunitete, Kryetari i Komunës dhe Arkiva.



Kryesuesi i Kuvendit
Xhelal Gashi

Raporti I punës së komitetit për komunitete për vitin 2016

Kam kënaqësinë të prezentoj raportin vjetor të punës dhe aktivitetit të komitetit për komunitete për vitin 2016-të.

Jemi munduar të përmbushim planin në fushat kryesore.

Ky komitet është i përberë nga 5 anëtarë:

- Nazife Krasniqi LDK
- Vlora Dema LVV
- Pranvera Loku-Zharku PDK
- Elmi hane Malsiu - Shoqëria civile "HANDIKOS"
- Shemsedin Abazi – Shoqëria civile KMLDNJ

		REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA		
		KOMUNA E KAÇANIKUT		
		OPSTINA KAÇANIK		
I	Data	18.01.17	Vendi	KASABLIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		104-1697	✓

Komiteti për komunitete gjatë vitit 2016-të ka mbajtur 4 takime(seanca).

Takimi I parë është mbajtur me datën 05.02.2016 në sallën e komiteteve të kuvendit me fillim pune prej orës 13:00.

Pjesëmarrës në këtë takim ishin të gjithë anëtarët e komitetit për komunitete.

Duhet cekur se në këtë takim znj. Pranvera Loku ishte anëtare e këtij komiteti e emëruar në vend të z. Kadri Krivanjeves, i cili ka ofruar dorëheqje nga ky komitet.

Në këtë takim ishte i ftuar të marrë pjesë kryesuesi i kuvendit të komunës z. Xhelal Gashi në cilësinë e kryesuesit të kësaj mbledhje, pasi që ky komitet mbeti pa kryesues prej dorëheqjes së z. Kadri Krivanjevës- ish kryesues i këtij komiteti.

Deri në zgjedhjen e kryesuesit mbledhjen e udhëheqi kryesuesi i kuvendit.

Në këtë takim morën pjesë edhe z. Zylfi Koxha-drejtor i DBPZHR, z. Hajrush Dullovi-zyrtarë për informim, ndërsa punimet e mbledhjes i monitoroi z. Jeton Lika nga OSB-ja.

Mbledhjen deri në zgjedhjen e kryesuesit e udhëheqi z. Xhelal Gashi ku konstatoi se ka korum dhe hapi mbledhjen e parë të rregulltë.

Ky takim në rend dite pat vetëm 2 pika:

1. Zgjedhja e kryesuesit të komitetit për komunitete, dhe

2. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kështu sipas rregullave u aprovua rendi I dites dhe u kalua në shqyrtimin e pikave sipas radhës.

1.U be zgjedhja e kryesuesit të ketij komiteti ku njëzëri propozimi për kryesues e votuan dhe morën vendim që znj.Nazife Krasniqi të jete kryesuese.

Kështu që prej atij momenti ajo e vazhdoi mbledhjen si kryesuese,ku e njëjta insistoi që të ketë edhe zëvendës-kryesues/e që nuk u arritë.

Aprovimi I pikës së dytë të procesverbalit nuk pati vërejte, prandaj u aprovua njëzëri.

Takimi I dytë I komitetit për komunitete është mbajtur me datën 27.04.2016 në sallën e komiteteve të kuvendit,me fillim prej ora 10:00.

Të gjithë anëtarët e ketij komiteti ishin prezent,ndërsa nga ekzekutivi morën pjesë drejtori I DAK z.Enver Kamishi dhe zyrtari për informim znj.Fatlume Guri.

Nga OSB-ja mbledhjen e monitoroi z.Jeton Lika.

Mbledhjen e kryesoi znj.Nazife Krasniqi,ndërsa procesmbajtese ishte znj.Makfire Malsiu-zyrtare e kuvendit.

Në rend dite ishin keto pika:

1.Aprovimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

2.Gjendja aktuale në disa shkolla të vizituara nga komiteti për komunitete.

3.Klasët e bashkangjitura,gjendja e femijëve me aftësi te kufizuar që vijojnë mësimin në klasë të bashkangjitua,dhe numri I tyre që nuk janë perfshire në shkollim.

4.Të ndryshme.

1.Komiteti për komunitete e aprovoi njëzëri procesverbalin dhe kaloi në pikën e dytë.

2.Gjendja aktuale në disa shkolla të vizituara nga Komiteti për Komunitete.

Kemi vizituar shkollat në fshatërat: Elezaj,Bajnicë,Strazhë,QEAP "Agimi",shkollën fillore "Emin Duraku" në Kacanik.

Kemi identifikuar problemet dhe veshtirësitë që kane këto shkolla dhe kemi dale me një raport.

Nje kopje të ketij raporti ia kemi dorezuar zyrtarës se kuvendit.

Ne kete raport jane ngritur shqetesimet me rendesi që jane:

Shqetësimi I dy klasëve të bashkangjitura në shkollën fillore “Nazmi Osmani” në Elezaj,ku perveq nevojës për klasë kishin nevojë edhe për një asistent,sidomos gjatë udhëtimit.

Në këtë shkollë vetëm 12 nxënës vijnë në mësimet në klasë të specializuara,e në realitet në kuadër të komunës ishin edhe aq fëmijë me nevoja të veqanta e që nuk figurojnë të regjistruar në asnjë shkollë.

Në shkollën e Bajnicës si kërkesë kryesore ishte që paralelja me fëmijët parashkollorë që kishte një numër prej 12 nxënësve të kenë kushte më të mira, ku ky komunitet ishte në gjendje të participojë për ti bërë zgjidhje këtyre fëmijëve.

Në këtë shkollë ju mungonin edhe kushte tjera si:nxehmja,salla për edukatë fizike,kabinete,etj.

Në shkollën “Dituria” të fshatit Strazhë u informuam se mësimi zhvillohej në tri klasë të kombinuara,e si njëra nga kërkesat kryesore të tyre ishte që mësimi të mbahej veq e veq,sidomos nxënësit e klasës së parë.

Tjetër kërkesë ishte edhe sigurimi I rrethojës së shkollës,ndërsa nxehmjet dhe kompjuterët I kishin siguruar nga donatorë të ndryshëm.

Në QEAP “AGIMI” kemi pasur shumë kërkesa:sigurimi I rrethojave të jashtme,lyerja e jashtme e objektit,rregullimi I kopshtit,I qeshmeve,gypat me c’rregullime,dëme të ndryshme,lagështi,rritja e numrit të edukatoreve dhe të kenë në dispozicion një sallë gjatë festave për prindërit.

Në shkollën fillore “Emin Duraku” në Kacanik kërkesat kryesore ishin:zgjidhja e hapësirave të pamjaftueshme të klasëve në raport me numrin e nxënësve,d.m.th ka më shumë nxënës se sa duhet mesatarisht për një klasë,mungesa e kabineteve,salla e edukates fizike,mungesa e toaleteve,probleme me kulmin e shkollës ku edhe pas dy here rregullimi të saj prap kishte c’rregullime,etj.

Në këtë takim të komitetit për komuniteteve u vendos unanimisht të ju mundësojmë një shëtitje fëmijëve me nevoja të veqanta.

Nga donatorë të kompanive “Kivo” dhe “Bk” e realizuam këtë shëtitje në Gjilan-“Vali Ranch” dhe “Planeti”,ku transportin e siguroi komuna.

Takimi I 3-të I komitetit për komunitete është mbajtur me datën 31.10.2016.

Në rend dite kemi pasur pikat:

- 1.Aprovimi I procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
- 2.Problemet e shendetësisë në kuader të komunës së Kacanikut.

3.Takimi me shoqatën e pensionistëve.

4.Kerkesa e komunitetit të lagjes “Dushkaja” për hapjen e paraleles së klasës së parë,në kuadër të shkollës së Dushkajës.

5.Të ndryshme.

Nga ekzekutivi I komunës në mbledhje mori pjesë ushtruesi I detyres së drejtorit të QKMFK-së z.Nejazl Ilazi I autorizuar nga drejtoresha e shëndetësisë.

Pasi filluam me rendin e ditës,njëzëri u aprovua procesverbali,për të kaluar më pas në pikën e dyte.

2.Në vizitën që I kemi bërë QKMFK-së jemi njoftuar me gjendjen dhe funksionimin e saj,numrin e mjekëve,infermierëve,punëtorëve administrativ dhe punëtorëve tjerë.

Ne u njoftuam për mungesën e gjinekologut-es,duke shpresuar që kjo zbrazëti të përmbushet me arsyetimin që disa mjekë ishin në specializim.Përveq kësaj,nuk kishte një dhomë për këshillë-dhënie për gratë ose nënat e reja.

Gjithashtu kishte mungesë të pediatri/es.

Ne kërkuam që të kete vizita dhe kontrole nëpër shkolla.

Poashtu në këtë takim kërkuam që të ketë kriteret komuna në cështjen e specializimit të mjekëve,sepse pas specializimit mjekët të cilët paguhen nga taksat e qytetarëve po na ikin nga komuna jonë.Ne po kemi mungesë për mjekë/e dhe specialistë/e.

Ne u njoftuam se 4 qendrat e mjekësisë familjare nuk e kanë funksionin si qendra të mjekësisë familjare në bazë të statusit.D.mth ato duhet të funksionojnë 24 orë pa ndërprerë.

Ne si komitet që të njoftohemi me gjendjen e shëndetësisë në teren,kemi ftuar administratorët e fshatërave ku disa prej tyre nuk janë pergjigjur ftesës në fjale.

Ne permes ketyre administratoreve të fshatërave ia perciellëm kerkesat e tyre ushtruesit të detyrës së drejtorit.

Pikat e tjera të rendit të ditës nuk I shqyrtuam për shkak të mungesës së autoriteteve perkatëse.

Seancen e 4-të të komitetit për komunitete e kemi mbajtur me datën 08.12.2016 ku pikat e rendit të ditës ishin:

1.Procesverbali nga mbledhja e kaluar.

2.Takimi me OJQ-të.

3.Informatë nga shoqata e pensionerëve.

4.Kerkesë nga komuniteti I lagjës së Dushkajës për hapjen e paralelës së klasës së parë në shkollën e "Dushkajës".

5.Të ndryshme.

Në takim I kemi njoftuar përmes zyrtarës së kuvendit autoritetet e ekzekutivit.

Pjesëmarrës të takimit ishin:kryetari I komunës z.Besim Ilazi dhe drejtori I arsimit z.Enver Kamishi.

Pas aprovimit njëzëri të pikës së parë kaluam në pikën e dytë.

2.Ne si komitet e kemi parë si të nevojshme që edhe zëri I shoqërisë civile të dëgjohet nga institucionet,pasi edhe ato paguajnë taksa komunale dhe është e arsyeshme që të jenë pjesë aktive e shoqërisë.

Në një takim të mbajtur më herët me datën 05.12.2016 ku morën pjesë përfaqësuesit e 8 OJQ-ve jemi njoftuar me gjendjen e tyre dhe I vlerësuam si shumë të dobishem për qytetarët tanë.

Ne ate takim morën pjesë përfaqësuesit e 8 OJQ-ve

- OJQ-ja për gazetari me përfaqësues z.Kjani Sallahu.
- OJQ-ja "Shoqata e mësuesve" me përfaqësuese znj.Estere Mjaku.
- OJQ-ja "Lidhja e gjallë e Kosoves" me përfaqësuese znj.Kadrije Piliqi.
- OJQ-ja "Klubi I shahut" me përfaqësues z.Aziz Koxha.
- OJQ-ja "Bjeshkatarët" me përfaqësues z.Valdet Raka.
- OJQ-ja "Gjethi" me përfaqësues z.Sami Stagova.
- OJQ-ja "Kryqi I kuq" me përfaqësues z.Naim Hysa.
- OJQ-ja "KVRL" me përfaqësuese znj.Erza.

Secila OJQ shprehu nevojat e tyre më me rendësi.

Ne si komitet për komunitete nxorëm këto konkluzione:

1.Komuna duhet që ti subvencionojë shoqatat dhe OJQ-të.

2.Te ketë një fond të veçantë për ta,ndërsa këto shoqata të shkojnë me plane konkrete,ku ne si shembull e morëm komunën e Kamenicës që I kishte ndarë 35000 euro për plotësimin e nevojave të ndryshme të OJQ-ve.

3.Të zbatohet ligji për sport.

4.Urgjentisht të bëhet zgjidhja për kalimin e hekurudhës nga ana e fëmijëve në mënyrë të sigurtë,që njëherit ishte edhe kërkesë e të gjitha OJQ-ve.

Për pikën e radhës që ishte hapja e paralelës së klasës së parë na premtuan që zgjidhja do të bëhet vitin e ardhshëm.

Pika tjetër në mungesë të autoriteteve përkatëse u anashkalua.

Si përfundim kërkuam që vitin e ardhshëm në takime të na përgjigjen autoritetet përkatëse që ne i ftojmë.

Varësisht prej pikave të rendit të punës këtë premtim na e dha kryetari,që mbesim me shpresë se do të realizohet.

N. Hoxhsmiçi